

MARRËVESHJE

në mes të

Republika e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja Ministry of Economic Development			
Nr. Sist. Org. Org. jedin. Org. Unit.	02	Nr. Prot. Sr. Prot. Prot. No.	2683
Nr. i faqëve Broj stranica No. pages:	3	Data Datum Date:	29.12.17
PRISHTINE/A			

Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik

dhe

Komunës së Gjakovës

Për bartjen e pronësisë së projektit kapital për Projektin:

“Programi Mbështetës - Auditimi i Energjisë në Ndërtesat e Shërbimit Publik”

Ministria e Zhvillimit Ekonomik (në tekstin e mëtejshëm: MZHE) dhe Komuna Gjakovë (në tekstin e mëtejshëm: Komuna), bazuar në formën standarde, e plotësuar në përshkrimin e projektit në Programin për Investime Publike, janë pajtuar për bartjen e pronësisë së projektit kapital: “Auditimi i Energjisë në Ndërtesat e Shërbimit Publik - Program mbështetës”, si në vijim:

Neni 1

Objekti i marrëveshjes

1. Projekti kapital “**Auditimi i Energjisë në Ndërtesat e Shërbimit Publik -Program mbështetës**”, **me nr. identifikues: 43800/17/013/521**, për vitin 2017 është në objektin SHFMU “**Gjergj Fishta**” në Bishtazhin, Gjakovë.

2. Vlera e financimit sipas objektit SHFMU “**Gjergj Fishta**” në Bishtazhin, Gjakovë është 25154.87 Euro.

Neni 2

Përgjegjësitë

1. Komuna merr në pronësi pasurinë kapitale nga Neni 1 i kësaj Marrëveshje.
2. MZHE, me qëllim të zbatimit të rekomandimeve nga projekti: Studimi i stokut të ndërtesave publike për auditim të energjisë, ka financuar dhe përfunduar së instaluari projektin nga Neni 1, e financuar dhe e cilësuar si pasuri kapitale e Qeverisë së Kosovës.
3. MZHE ruan të drejtën e shfrytëzimit të dhënave nga zbatimi i rekomandimeve të projektit nga Neni 1, pika 2 (në tekstin e mëtejshëm: Objekti i Marrëveshjes).

Neni 3

Menaxhimi dhe mbikëqyrja e projektit

1. Komuna merr në pronësi dhe menaxhim të plotë dhe pa kurrfarë kufizimi projektin nga Objekti i Marrëveshjes (Secila pjesën e vet nga Neni 1, pika 2 e marrëveshjes).
2. Komuna mirëmban dhe bart të gjitha obligimet tjera që mund të dalin për funksionimin e rregullt të projektit nga Objekti i Marrëveshjes, duke përfshirë gjeneratorin përkatës si dhe mbushjen e sistemit të ngrohjes me antifriz si masë shtesë për funksionim normal të sistemit.
3. Komuna, (pjesë shtesë të këtij dokumenti) do ta ketë në pronësi të gjithë dokumentacionin që bën të formalizuar projektin nga Objekti i Marrëveshjes;

3.1 Në cilësinë e dokumentacionit, që bën të formalizuar projektin, ofrohen:

3.1.1 Kontrata: **43800/17/013/521;**

3.1.2 Urdhëresat e pagesave; si dhe

3.1.3 Faturat e projektit.

Neni 4 **Gjendja teknike e projektit**

MZHE i dorëzon Komunës projektin nga neni 1 pika 2 të kësaj marrëveshje, në gjendje të rregullt teknike dhe sipas standardeve të kërkuara në termat e referencës. Të gjitha këto duhet të jenë të vërtetuara nga komisioni përkatës i themeluar nga MZHE.

Neni 5 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Palët bëjnë përpjekje për ti zgjidhur mosmarrëveshjet eventuale që kanë ndërmjet veti përmes mirëbesimit ose bisedimeve të përbashkëta. Ndonjë konflikt, kërkesë e cila vjen si interpretim i marrëveshjes, duke përfshirë esencën e saj, vlefshmërinë apo përfundimin, do të zgjidhet nga Gjykata kompetente në Prishtinë.

Neni 6 **Amendamentet**


Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e nënshkruesve të marrëveshjes.

Neni 7 **Hyrja në fuqi**

Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje mbi bartjen e pronësisë do të filloi të zbatohet nga dita e nënshkrimit të saj.

Në emër të:

Ministrit të Zhvillimit Ekonomik


Nazmi Zenelaj - Sekretar i Përgjithshëm

Në emër të:




Komuna Gjakovë


Kryetari



Prishtinë

Data e nënshkrimit: 19.12.2017



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministrastvo Ekonomskog Razvoja / Ministry of Economic Development

PRANIM DORËZIMI I PASURISË

Në bazë të marrëveshjes me nr. Protokolli të MZFIH-së 2683 të bëhet pranim dorëzimi i pasurisë me kod të projektit 12722 nga komuna në bazë të shumës së përcaktuar në marrëveshje.

Dorëzoi:

Ministria e Zhvillimit Ekonomik

Zyrtar i lartë i Pasurisë: Besa Kërçeli

Nënshkrimi:

Data: 29.12.2017

Pranoi:

Komuna e Gjakovës

Emri dhe mbiemri:

Nënshkrimi:

Data: 29.12.2017